

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Balla kundër draftit të PD për ndarjen territoriale: Do të ndjekim procedurën parlamentare
ADRESA	https://albeu.com/lajme/balla-kunder-draftit-te-pd-per-ndarjen-territoriale-do-te-ndjekim-proceduren-parlamentare/1027537/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 17:16:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 17:15:15 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	951f1876b3927e2481442f7dfbe0ec2fbe0a0724d301ee47184067e64e2b23ae
TEKSTI	b82a37deb137ffb8de9f9d585670ae9cb06c89c2a2cb0b8bb21a175ac71096a9
PAMJA	ab30c4c68b6f68a2d31e7506453887f1cd480801f65dfcbb21cbd0787c1cc9fb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5da683a6f452321bf6d0b352aac9ab0151f015d95917d37727a68d81328b2a28
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	96339b4c2dc892b32bb4ef058b3a026fd313b806f95d2de1cfb905f974369f65
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5da683a6f452321bf6d0b352aac9ab0151f015d95917d37727a68d81328b2a28>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Balla kundër draftit të PD për ndarjen territoriale: Do të ndjekim procedurën parlamentare



Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, ka reaguar për nismën e Partisë Demokratike, e cila ka depozituar një draft për riorganizimin administrativo-territorial të Shqipërisë.

Sipas propozimit të opozitës, vendi duhet të ndahet në 100 bashki dhe 12 qarqe. Dokumenti shoqërohet me një relacion prej 168 faqesh, ku PD thotë se ka shqyrtuar kriteret ligjore e teknike, si edhe nevojat e komuniteteve për një mënyrë të re të qeverisjes vendore.

Balla e ka cilësuar nismën e demokratëve si një "draft alternativ (retro)" dhe ka nënvizuar se ajo duhet të kalojë më parë përmes gjithë hapave të përcaktuar nga procedura parlamentare.

"Pasi thanë se Komisioni i Posaçëm nuk e ka mbaruar punën, sot Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike paska ardhur me një propozim alternativ (retro) për reformën administrative territoriale, falë konsultimeve të gjata në kuadër të punës së Komisionit. Ja pra Komisioni ia vlejti", shkruan Balla.

Sipas tij, drafti duhet t'u dërgohet për mendim këshillave bashkiakë dhe Qeverisë, ndërsa procesit duhet t'i lihet koha e nevojshme.

"Siç e parashikon procedura parlamentare ky draft duhet t'u shkojë këshillave bashkiake dhe Qeverisë për mendim. Duhet të marrë kohën e vet", vijon ai.

Ndërkohë, kreu i grupit socialist njofton se mazhoranca do të vazhdojë me nismën e saj, në përputhje me afatet e parashikuara në Kalendarin e Kuvendit.

"Ndërkohë vazhdojmë procedurën parlamentare me propozimin tonë, siç është përcaktuar në Kalendarin e Kuvendit. Menjëherë më pas, maksimumi pas zgjedhjeve vendore të pranverës, Komisioni i Posaçëm do duhet të ringrihet për ta vijuar reformën e bashkive europiane në një nivel tjetër", shprehet Balla.

të fundit /



Skandal me fondet e investimeve në Turqi, 45 persona arrestohe...



Balla kundër draftit të PD për ndarjen territoriale: Do të...



Cristian "Cutî" Romero emërohet kapiteni i ri i Argjentinës pas Lione...



Bajqinovci ironizon tarifën në Prishtinë: A do të paguajnë...



PDK-ja miraton deklaratën politike, kërkon ndryshime në...



Qarri: Aktgjykimi i Speciales lidhet me individë, ndërsa PDK...



Shqipëria konfirmon mungesën e Klisman Cakes në sfidën...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

PD, nga ana tjetër, argumenton se nisma për 100 bashki dhe 12 qarqe nuk synon vetëm shtimin e numrit të njësive vendore, por edhe transformimin e modelit të qeverisjes lokale.

Opozita deklaron se përmes këtij drafti kërkon t'i afrojë më shumë institucionet me qytetarët, të forcojë demokracinë vendore dhe përgjegjshmërinë, si edhe të përmirësojë shërbimet, autonominë financiare dhe zhvillimin e balancuar territorial.

Sipas PD-së, modeli i propozuar duhet të ndërtohet mbi decentralizim real, autonomi financiare, përcaktim të qartë të kompetencave, përgjegjësi e llogaridhënie, demokraci lokale dhe zhvillim të ekuilibruar të territorit.

Shtuar më 25.09.2026 19:15

Tags: PD , Politike , PS , Taulant Balla , vendi



Protesta qytetare hyn në ditën e 118-të, protestuesit kërkojnë largimin e Edi...



"Regjimi po kalon në një shpërbërje të turpshme"/ Berisha në Elbasan:...



Përplasje në aksin Elbasan-Peqin, lëndohen drejtuesi i automjetit dhe...



Rama pas incidentit me vezë në New York: Protestat nuk më ndalin,...



"Rreth 15 mijë dollarë nata"/ Marjana Koçeku: Rama shpenzon sa 5 vite...



Përplasje mes taksisë dhe furgonit me mësues në aksin Lezhë-Shkodër,...



Rama në Nju Jork: Shqipëria po krijon imunitet ndaj korrupsionit, dikur lu...



Tre të plagosur pas përplasjes së dy makinave në aksin Elbasan-Peqin



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.